MATERIAL STUDIMOR
31 (70) 2018
BANKA E SHQIPËRISË

A NDIKON RREZIKU PRIMAR SOVRAN MBI STABILITETIN BANKAR? EVIDENCA NGA SEKTORI BANKAR SHQIPTAR

GERTI SHIJAKU

MATERIAL STUDIMOR
31 (70) 2018
BANKA E SHQIPËRISË

A NDIKON RREZIKU PRIMAR SOVRAN MBI STABILITETIN BANKAR? EVIDENCA NGA SEKTORI BANKAR SHQIPTAR

Gerti Shijaku

Gerti Shijaku
Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë, gshijaku@bankofalbania.org

Falenderime: Autori i është mirënjohës, veçanërisht z. Franco Fiordelisi, për mbështetjen, komentet dhe sugjerimet e vlefshme. Gjithashtu, falënderon Departamentin e Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë për ndihmën dhe mbështetjen.

Shenim: Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërish ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

ABSTRAKT 7

1. HYRJE 7

2. LITERATURA 11

3. METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT 16

4. REZULTATET EMPIRIKE 24

5. KONKLUZIONE 31

LITERATURA 33

SHTOJCA 40

ABSTRAKT

Ky material diskutimi analizon në mënyrë empirike faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që lidhen me stabilitetin bankar, veçanërisht nëse rreziku primar sovran ndikon stabilitetin bankar. Për këtë arsye, ne kemi ndjekur një metodë të re për përllogaritjen e një indeksi rreziku për sistemin bankar shqiptar, i cili bazohet në të dhënat e bilancit kontabël që raportohen nga bankat dhe pasqyron gjendjen e tyre në aspektin individual. Modeli vlerësohet nëpërmjet metodës së përgjithshme të momenteve me të dhëna panel për periudhën T3 2008 – T3 2015. Rezultatet mbështesin pikëpamjen se rreziku primar sovran nuk ndikon stabilitetin e bankave, ndonëse efekti i tij është gjetur negativ. Përkundrazi, është gjetur se përmirësimi i kushteve makroekonomike dhe i atyre financiare përbëjnë ndër faktorët e jashtëm më të rëndësishëm. Në të njëjtën kohë, leva financiare dhe eficienca operative janë ndër faktorët specifikë të bankave që e ndikojnë më tepër stabilitetin.

Kodi JEL: C26, E32, E43, G21, H63.

Fjalët kyçe: Stabiliteti bankar, rreziku primar sovran, të dhëna panel, MPM.

1. HYRJE

Kriza financiare globale (KFG) e vitit 2007 ritheksoi edhe një herë se stabiliteti i sektorit financiar shqiptar është shumë i varur nga zhvillimet që lidhen me sistemin bankar [Banka e Shqipërisë (2015)]. Kjo për shkak se sistemi bankar përbën sektorin kryesor për mbështetjen e aktivitetit ekonomik, i cili mund të dëmtohet seriozisht, nëse bankat, agjentët më të shquar në tregjet financiare, shfaqen në disa momente të trazuara dhe nuk mund të kryejnë siç duhet funksionin e tyre financiar. Kjo u bë edhe më e dukshme në periudhën e krizës së borxhit grek, në të cilën sistemet bankare në të gjitha vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore (ELJL), dhe në veçanti Shqipëria, u përballën me disa sfida të rëndësishme. Së pari, bankat duhej të financonin një politikë fiskale vendase

ekspansioniste, në një kohë kur tregjet financiare filluan të vënë në pikëpyetje aftësinë paguese të vendeve me një nivel borxhi relativisht të lartë, ndërkohë që spread-et në rritje u bënë nxitësi kryesor për një rrezik të mundshëm sistemik për të gjitha bankat evropiane, veçanërisht në fund të vitit 2011 dhe në verën e vitit 2012 [Black, et al., (2016)]. Së dyti, efektet 'spill-over' dhe problemet në bilancin kontabël të bankave shqiptare shkaktuan një tkurrje të fluksit të kreditimit bankar ndaj sektorëve të tjerë të ekonomisë vendase për shkak të nevojës për 'de-leverage'. Në të njëjtën kohë, pavarësisht një politike monetare stimuluese, spread-et në rritje u shoqëruan me një rritje të brishtësisë së sistemit bankar (shih grafikun 1 në Shtojcë), ndjekur kjo nga shtrëngimi i kushteve financiare në disa sektorë dhe tërheqja e konsiderueshme e flukseve të kapitalit në ekonomi dhe/apo financim të borxhit, duke e bërë atë më të shtrenjtë dhe të vështirë për të mbështetur ekonominë nëpërmjet kreditimit.

Nga pikëpamja empirike, literatura ekzistuese paraqet një analizë të plotë lidhur me faktorët e brendshëm (mikro) dhe ata të jashtëm (makro) që përcaktojnë stabilitetin bankar. Gjithsesi, përtej këtyre rasteve, një çështje kërkon ende një përgjigje empirike, pasi ende nuk ka dëshmi lidhur me efektin që rreziku primar sovran ka tek stabiliteti bankar në rastin e një ekonomie të vogël të hapur në zhvillim, pra si Shqipëria, dhe në veçanti pas KFG-së. Prandaj, qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë se si dhe në çfarë mase përçohet efekti i këtij rreziku në stabilitetin bankar, i cili mund të sjellë si përfundim një rritje të brishtësisë financiare. Për këtë arsye, studimi bazohet tek një kampion me të dhëna tremujore për 16 banka që operojnë në sektorin financiar shqiptar gjatë periudhës 2008-2015. Metoda empirike për analizimin e hipotezës sonë ndjek një procedurë me pesë hapa.

Së pari, llogaritja e treguesit të stabilitetit bankar bazohet në të dhënat e bilancit kontabël dhe pasqyrat e bankave që raportohen në bazë të kriterit CAELS, të cilat më pas janë shndërruar në një matës të vetëm nëpërmjet metodës së Analizës së Komponentit Kryesor (AKK). Së dyti, ky tregues shprehet si funksion i treguesve të brendshëm (mikro) dhe atyre të jashtëm (makro) me të dhëna panel, i cili më pas vlerësohet nëpërmjet Metodës së Përgjithshme

të Momenteve (MPM). Në fundmi, analiza empirike pasqyrohet më tej me një sërë testesh të kontrollit të fortësisë së rezultateve. Në njërën anë, analiza përfshin një sërë treguesish për të shmangur problemin e identifikimit jo të plotë të modelit. Në anën tjetër, modeli zgjerohet më tej, duke përfshirë në të edhe një tregues shpjegues që lidhet me aktivitetin jashtë bilancit kontabël të bankave, në të cilin ato janë të përfshira dhe që mund të ketë pasojë për stabilitetin bankar.

Rezultatet e këtij studimi paraqesin prova të forta empirike që mbështesin pikëpamjen se rreziku primar sovran e ndikon negativisht stabilitetin e bankës. Megjithatë, efekti i përçimit të këtij rreziku është relativisht i ulët. Në të njëjtën kohë, vihet re se bankat janë më të ndjeshme ndaj zhvillimeve ekonomike dhe risqeve makroekonomike, të tilla si dominanca fiskale, stabiliteti financiar etj. Gjithashtu, edhe treguesit që lidhen me sjelljen specifike të bankave kanë rezultuar se ndikojnë mbi stabilitetin e bankave në një mënyrë të rëndësishme - veçanërisht risku i likuiditetit dhe i kapitalit, si dhe efikasiteti operacional. Gjithashtu, vërehet se përfshirja më e madhe në aktivitete jashtë bilancit lidhet negativisht me stabilitetin bankar, por ky efekt është relativisht i vogël dhe i parëndësishëm nga pikëpamja statistikore. Pjesa tjetër e rezultateve nënkupton që stabiliteti është më pak i ndjeshëm ndaj shkallës së ndërmjetësimit financiar, kapitalit të tepërt, përfitimit dhe rrezikut të kredisë.

Ky material plotëson literaturën ekzistuese lidhur me këtë çështje në tre aspekte kryesore. Së pari, në dijeninë tonë, ky është studimi i parë që analizon në mënyrë empirike lidhjen midis rrezikut primar sovran dhe stabilitetit bankar, veçanërisht duke u fokusuar vetëm në periudhën pas krizës financiare. Prandaj, gjetjet e këtij studimi mund të jenë mjaft të rëndësishme për investitorët dhe rregullatorët. Ky është gjithashtu studimi i parë që adreson çështjet midis rrezikut primar sovran dhe stabilitetit në rastin e një ekonomie në zhvillim, në veçanti në rastin e sistemit bankar shqiptar. Së dyti, ndryshe nga punimet e tjera, treguesi i stabilitetit nuk bazohet tek treguesit e përdorur gjerësisht, të tillë si rezultati Z dhe/apo raporti i kredive me probleme (KMP), për të cilat Fu, et al., (2014) ofrojnë disa argumente kundër, si një tregues për matjen e stabilitetit bankar. Në të kundërt, treguesi i përzgjedhur në këtë studim përfshin aspekte të

ndryshme të rreziqeve bankare - p.sh. mjaftueshmërinë e kapitalit, cilësinë e aktiveve, të ardhurat, likuiditetin dhe ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut - të cilat më pas u paraqitën në formën e një treguesi të vetëm nëpërmjet metodës statistikore AKK. Për këtë arsye, ne besojmë fuqimisht se ky tregues është cilësisht më i aftë për të identifikuar drejtpërdrejt faktorin kryesor që shpreh më mirë episodet e brishtësisë bankare, në kohë dhe pa humbur shumë informacion. Kjo qasje është e favorshme edhe për faktin se ai shmang çdo pengesë (p.sh. vëllimi i pamjaftueshëm i të dhënave ose sinjaleve false) që lidhet me përdorimin e qasjes binare ndaj krizave (Hagen dhe Ho, 2007).

Me sa dimë, asnjë studim i mëparshëm nuk ka përdorur një tregues të tillë për të matur stabilitetin bankar si tregues të varur, në kontekstin e analizimit se si ndikohet stabiliteti bankar nga rreziku primar sovran, dhe besojmë se ky është një hap i rëndësishëm përpara drejt të kuptuarit më të mirë të mekanizmave themelorë. Së fundi, ky studim shmang çdo pengesë, siç përshkruhet edhe nga Uhde dhe Heimeshoff (2009), që lidhet me çështjet e të dhënave në panel për vende të ndryshme, si dhe siguron krahasueshmëri midis treguesit të varur dhe atyre të pavarur, nisur nga fakti se ky studim përqendrohet në një vend të vetëm. Në mënyrë të ngjashme, ky studim nuk bazohet tek të dhënat e marra nga baza e të dhënave të Bankscope, por burimi i tyre lidhet me bazën e të dhënave të marra nga Banka e Shqipërisë, e cila përbën një burim më të saktë dhe më të besueshëm të të dhënave bankare.

Materiali është strukturuar si më poshtë: seksioni 2 paraqet një përmbledhje të literaturës së lidhur me këtë çështje; seksioni 3 shpjegon aspektet kryesore të metodologjisë; rezultatet paraqiten në seksionin 4; përfundimet e materialit përmblidhen në seksionin 5.

2. LITERATURA

Në përputhje me pikëpamjet e duhura teorike, shumë studime të kohëve të fundit janë përpjekur të analizojnë empirikisht çështjet që lidhen me stabilitetin bankar. Megjithatë, ato mund të përmblidhen në dy forma. Në njërën anë qëndrojnë studimet relativisht të lidhura me qasjen për shndërrimin e episodeve të brishtësisë bankare apo edhe matjen e kësaj dukurie nëpërmjet treguesve binarë dhe/apo cilësorë. Në anën tjetër, qëndron grupi i studimeve, të cilat janë thelbësore për të kuptuar formën sipas së cilës janë studiuar fenomene të caktuara që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/apo të tërthortë me stabilitetin bankar.

2.1. RISHIKIMI I LITERATURËS LIDHUR ME TREGUESIN E STABILITETIT BANKAR

Rishikimi i literaturës për matjen e rrezikut bankar paraqet një sërë treguesish të ndryshëm, pjesa më e madhe e të cilëve janë të lidhur me bilancin kontabël të bankave dhe mund të përdoren për matjen e brishtësisë bankare dhe/apo rrezikun bankar. Megjithatë, nuk ka asnjë konsensus nëse ndonjëri prej tyre përbën një tregues relativisht përshtatshëm për të matur rrezikun dhe/apo stabilitetin bankar [Noth dhe Tonzer (2015)]. Për shembull, midis shumë autorëve, Boudebbous dhe Chichti (2013) pajtohen me faktin se stabiliteti bankar është potencialisht i vështirë të përcaktohet e të matet, për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme në mjedisin financiar dhe atë bankar. Disa autorë, e trajtojnë çështjen për matjen e treguesit të stabilitetit bankar nga pikëpamja e mungesës së krizave dhe volatilitetit ose stresit të tepërt apo në këndvështrimin e një gjendjeje të qëndrueshme 'steady state', në të cilën sistemi financiar (bankar) kryen në mënyrë efikase funksionet e tij kryesore ekonomike, siç janë shpërndarja e burimeve dhe e rrezikut, si dhe mundësimi i pagesave [Deutsche Bundesbank (2003) dhe Jahn dhe Kick (2012)].

Në këtë aspekt, literatura ndahet në tekste që i përdorin treguesit e lidhur me stabilitetin bankar, për vlerësimin e efekteve të tij tek

tregues të tjerë; dhe në ato që fokusohen në analizimin e ndikimit që faktorë të ndryshëm kanë mbi stabilitetin bankar. Grupi i parë përmban: studime që përdorin tregues të vetëm dhe/ose të përbërë; studime që identifikojnë treguesit kryesorë që lidhen me stabilitetin bankar; si dhe studime që llogarisin tregues të bazuar tek qasja e sistemeve të paralajmërimit të hershëm, në të cilat vlerësohen, në mënyrë empirike, shkaqet e periudhave jo të qëndrueshme sipas një qasjeje ex post. Për shembull, disa i referohen riskut bankar duke u bazuar tek tregues të tillë si rezultati Z, i cili paraqet distancën e bankës nga falimentimi i mundshëm dhe llogaritet si diferenca midis fitimit të bankës dhe kapitalit aksioner të saj, të shprehur si raport ndaj luhatshmërisë së fitimit të bankës. Kjo qasje përfshin studimet e: Demirgüç-Kunt, et al., (2008); Berger, et al., (2009); Kasman dhe Kasman (2015); Dushku (2016); dhe Noth dhe Tonzer (2015). Nga ana tjetër, ekziston edhe një grup tjetër studimesh që bazohen tek tregues të tillë si raporti i kredive me probleme [Berger, et al., (2009); Jiménez, et al., (2013)], dhe/apo humbjet nga provigjionimi [Noth dhe Tonzer (2015); Dushku (2016)].

Në pikëpamjen e treguesve rregullatorë makroprudencialë, disa studime janë bazuar tek treguesit binarë[1], të cilët mbështeten tek kombinimi i të dhënave makroekonomike dhe atyre në nivel bankar, për të sinjalizuar periudhat e brishtësisë dhe/apo paqëndrueshmërisë. Megjithatë, Hagen dhe Ho (2007) shprehen kundër përdorimit të këtyre treguesve, pasi qasja binare mund të japë një informacion jo të saktë për dy arsye kryesore. Së pari, ndërhyrjet e autoritetit të mbikëqyrjes bankare mund të ndodhin edhe në mungesë të një krize akute në sektorin bankar. Së dyti, jo çdo krizë çon në një ndërhyrje të dukshme të këtij autoriteti, pasi bankat qendrore dhe rregullatorët mund të jenë në gjendje të shmangin me sukses një krizë, duke përdorur mjete më pak spektakolare.

Për shembull, duke u bazuar tek një qasje jobinare, Fiordelisi, et al., (2011) mat rrezikun e bankës përmes një treguesi të frekuencës së akumuluar të falimentimit të pritur[2]. Për analogji, për të njëjtin

[1] Shih ndër të tjerë: Illing dhe Liu (2006); Jahn dhe Kick (2012); Cevik, et al., (2013); Shijaku (2017a); dhe Shijaku (2017b).

[2] Ky tregues llogaritet nga Moody's, duke u bazuar në trashëgiminë e modelit të Kealhofer, McQuown dhe Vasicek, i cili shkurtimisht njihet si modeli KMV.

qëllim, Ötker dhe Podpiera (2010) bazohet tek treguesi i shkëmbimit të falimentimit të kredisë (CDS). Ndërkohë, në studimin e tyre Cleary dhe Hebb (2016) bazohen tek treguesi Z, i cili është një tregues kontabël që mundëson analizimin njëherësh (jo në mënyre sekuenciale) dhe në kohë të karakteristikave individuale të bankave dhe/apo një sektori të caktuar, në raport me sjelljen që lidhet me riskun bankar. Nga ana tjetër, Black, et al., (2016) mbështeten tek treguesi i primit të sigurisë së rrezikut të brishtësisë, i cili është një ndërthurje e madhësisë së bankës, probabilitetit të falimentimit të bazuar tek CDS, dhe korrelacionit të kthimit nga kapitali aksioner.

2.2. RISHIKIMI I LITERATURËS MBI QASJEN EMPIRIKE PËR ANALIZIMIN E ÇËSHTJEVE QË LIDHEN ME STABILITETIN BANKAR

Efektet e krizës financiare të vitit 2007 sollën edhe një herë çështjen e rrezikut të bankës në zemër të diskutimit akademik, i cili mund të kategorizohet gjithashtu si më parë, nga pikëpamja teorike dhe ajo empirike. Në rastin e parë, rishikimi i literaturës fokusohet kryesisht tek faktorët që përcaktojnë stabilitetin bankar. Në këtë aspekt, Hutchison (2002) bën një dallim midis tre grupe modelesh, të tilla si: modeli i falimentimit të bankës, si në rastin e Diamond dhe Dybving (1983); modeli i goditjeve të tërthorta të kanalit të kredisë, sipas sugjerimit të Bernanke, et al., (1992); dhe modeli i rrezikut moral sipas Demirgüç-Kunt dhe Detragiache (2002). Nga ana tjetër, kuadri empirik, identifikon disa tregues potencialë në përputhje me një ose më shumë modele teorike që përfshihen në dy kategori kryesore, domethënë, përcaktuesit e brendshëm dhe ata të jashtëm. Kategoria e parë përbëhet nga tregues të ndikuar nga objektivat e politikës së menaxhimit të bankës dhe aftësia e tyre për të monitoruar rreziqet dhe, në këtë mënyrë, përqendrohet në treguesit tipikë që bazohen në bilancin kontabël të bankës, të tilla si: madhësia; cilësia e aktiveve; niveli i likuiditetit dhe kapitalizimit të bankës; efikasiteti operacional; dhe leva financiare. Ndër këto studime, Caprio dhe Klingebiel (1997) përmendin si burim kryesor të brishtësisë bankare aftësinë e tyre për të monitoruar cilësinë e kreditimit, ndërsa Dell'Ariccia, et al., (2008) tregojnë se standardet

e lidhura me huadhënien bankare mund të bien, veçanërisht gjatë krizave të huadhënies bankare dhe flluskave të çmimit të banesave, për shkak se bankat janë të detyruara të mbajnë një nivel të caktuar të ardhurash dhe/ose synojnë të jenë përsëri pjesë e tregut. Gjithashtu, për autorë të tjerë, si p.sh. Diamond dhe Rajan (2005) dhe Jutasompakorn, et al., (2014), arsyeja pse dështimet e bankave janë ngjitëse është e njëjtë me arsyen që aktivet e tyre janë jolikuide dhe mungesa sistematike e likuiditetit në tregun ndërbankar të parasë, si dhe rritja e integrimit financiar mund të bëjë që presionet e likuiditetit të kthehen lehtë në çështje të paaftësisë paguese sistemike. Kjo konfirmohet edhe nga gjetjet e Berger dhe Bouwman (2013), të cilët sugjerojnë se kapitalizimi i mirë i bankave është thelbësor për të amortizuar goditjet negative gjatë episodeve të trazuara.

Kategoria tjetër e treguesve të përfshirë në studimin e çështjeve që lidhen me stabilitetin bankar bazohet tek treguesit makroekonomikë dhe të industrisë bankare. Pra ky grup treguesish janë ekzogjenë në raport me vendimmarrjen dhe politikat specifike të bankës. Në këtë pikëpamje, sipas Demirguc-Kunt dhe Detragiache (2002), një grup tjetër treguesish janë të lidhur me problemet e mbikëqyrjes bankare, të tilla si aspektet ligjore për zbatimin e kontratave, burokracinë dhe standardet e kontabilitetit, instrumentet e sigurimit të depozitave etj. Për shembull, Pill dhe Pradhan (1997) konfirmojnë një korrelacion pozitiv midis brishtësisë bankare dhe bumit të kredive. Ndërkohë, Eichengreen dhe Rose (1998) e vënë më shumë theksin në efektin që ka spread-i në rritje dhe interesat e larta, të cilat mund të jenë tregues të: problemeve bankare; nevojës për të frenuar normat e larta të inflacionit; dhe të nevojës për të ruajtur çmimin e monedhës vendase; të cilat kanë të ngjarë të dëmtojnë bilancin e bankës, edhe nëse është e mundur të trasferohen pjesërisht tek huamarrësi.

Kaminsky dhe Reinhart (1998) zbuluan gjithashtu se deficitet fiskale të mëdha dhe të përkeqësuara tentojnë të rrisin probabilitetin e krizave bankare, ndërkohë që efekti i rritjes së bazës monetare është i papërfillshëm. Midis këtyre studimeve, Honohan (2000) zbulon se kriza shpesh ndodh në pjesën e dytë të cikleve të bumit ekonomik, ndërsa një numër studimesh raportojnë se kriza ka më pak gjasa të ndodhë në vendet: me rritje reale të fortë ose pozitive;

luhatshmëri më të ulët të presioneve inflacioniste; dhe menaxhim më të mirë të flukseve të kapitaleve të huaja [Demirguc-Kunt dhe Detragiache, (2005)]. Jahn dhe Kick (2012) konstatojnë se stresi bankar lidhet më shumë me nivelin e përqendrimit të portofoleve të huave bankare, dhe kjo lidhet me faktin se bankat e specializuara priren të jenë më të qëndrueshme sesa ato të diversifikuara. Në të njëjtën kohë, Boudebbous dhe Chichti (2013) raportojnë se normat e larta të zgjerimit të kredisë mund të financojnë një flluskë çmimi të aktiveve e për pasojë, një rritje të brishtësisë bankare, të cilat shpesh paraprihen nga përkeqësimi i kushteve të tregtisë, por edhe nga mbiçmimi i kursit të këmbimit, edhe pse Domac dhe Martinez-Peria (2003) konkludojnë se kohëzgjatja e krizave nuk duket të jetë e ndikuar nga zhvillimet në kursin e këmbimit. Nga ana tjetër, duke u bazuar tek studimi i periudhës para vitit 2007, Cole dhe White (2012) përdorin një model regresioni logaritmik të shumëfishtë për të analizuar arsyen pse bankat tregtare dështuan gjatë krizës së fundit financiare. Ata dalin në përfundimin se treguesit kryesorë që lidhen me kriteret e CAMELS-it janë potencialisht mjaft efikas për të shpjeguar dështimet e bankave që u mbyllën gjatë vitit 2009. Edhe Fahlenbrach, et al., (2012) dëshmojnë se ecuria përgjatë krizës së vitit 1998 e kthimit nga investimi në aksione, ishte një mjet i mirë për të parashikuar probabilitetin e dështimit gjatë krizës. Autorët gjithashtu treguan se mbështetja në financimin afatshkurtër, levat e larta dhe ritmet e larta të rritjes, janë të lidhura me performancën e dobët të bankave në të dy krizat.

Midis studimeve të tjera, Aubuchon dhe Wheelock (2010) shqyrtojnë brishtësinë e bankave, për periudhën 1 janar 2007 - 31 mars 2010, duke u fokusuar kryesisht në karakteristikat ekonomike rajonale të lidhura me dështimet bankare, se sa në treguesit specifikë të bankave. Studime të tjera, ndër të cilët ato të realizuara nga Ivashina dhe Scharfstein (2010), Campello, et al., (2011) dhe Dwyer, et al., (2011), janë fokusuar tek kanali i kredisë. Në këtë mënyrë, ata dëshmojnë se bankat kanë ulur masën e huadhënies përgjatë krizës, për të shmangur goditjet e lidhura me rrezikun e likuiditetit. Beltratti dhe Stulz (2012) konfirmojnë gjetjet e Laeven dhe Levine (2009), në lidhje me periudhën para KFG-së, por sfidojnë qëndrimin se mbikëqyrja e dobët bankare ishte ndër shkaktarët kryesorë të kësaj krize. Nga ana tjetër, në një studim të

fundit, DeYoung dhe Torna (2013) gjejnë se mënyra e realizimit të të ardhurave bankare dhe veprimtaria në të cilën këto banka u përqendruan ishin ndër shkaktarët kryesorë të brishtësisë bankare të krizës. Berger dhe Bouwman (2013) fokusohen tek efekti i kapitalit. Autorët pranojnë se efekti i kapitalit ndaj probabilitetit të mbijetesës dhe madhësisë së bankës ndryshon përgjatë krizave bankare, ashtu si dhe në kohë normale. Në veçanti, autorët dalin në përfundimin se kapitalizimi i mirë i bankës rrit probabilitetin e mbijetesës për bankat e vogla dhe përmirëson performancën e atyre të mesme dhe të mëdha, kryesisht gjatë krizave bankare. Nga ana tjetër, duke u mbështetur në studimin e Cole dhe White (2012), Antoniades (2015) argumenton se dështimet e bankave tregtare në SHBA mund të shpjegohen nga përkeqësimi i kushteve në sektorin e pasurive të paluajtshme - një proces që filloi që në vitin 2006 dhe zgjati edhe pas përfundimit të KFG-së. Autori identifikon tri burime të ekspozimit bankar në sektorin e pasurive të paluajtshme, të cilat veprojnë nëpërmjet aktiveve të saj: (a) aktivet jolikuide; (b) letrat me vlerë të tregtueshme; dhe (c) portofolet e linjës së kredisë jashtë bilancit kontabël.

3. METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT

3.1. TREGUESI I STABILITETIT BANKAR

Nga pikëpamja e strukturës, sektori bankar përbën segmentin më të rëndësishëm të sistemit financiar shqiptar dhe si i tillë, kërkon një vëmendje më të madhe kur bëhet fjalë për analizat financiare të tij (Kalluci, 2011), ndërsa vlerë të shtuar përbën trajtimi i bankave në aspektin individual. Prandaj, në ndryshim nga matësit e tjerë të përllogaritur në Bankën e Shqipërisë[3], në këtë punim, pikënisja e matjes dhe ndërtimit të një treguesi të stabilitetit bankar është Sistemi Uniform i Vlerësimit Financiar, prezantuar në vitin 1979 në legjislacionin e SHBA-ve, të referuar si vlerësimi CAELS (mjaftueshmëria e kapitalit, cilësia e aktiveve, fitimi, likuiditeti dhe

[3] Shih: Kalluci (2011); Kota dhe Saqe (2013); Shijaku (2014); Saqe, et al., (2015).

ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut (shih Tabelën 2 në Shtojcë[4]). Së pari, treguesit e përfshirë në secilën prej këtyre kategorive janë normalizuar në një shkallë të përbashkët me mesatare zero dhe devijim standard 1[5]. Formula paraqitet si më poshtë:

$$Z_t = \left(\frac{X_t - \bar{\bar{\mu}}}{\bar{\sigma}}\right) \qquad (1)$$

ku: X_t përfaqëson vlerën e treguesit X gjatë periudhës t; μ është mesatare dhe $\bar{\sigma}$ është devijimi standard. Së dyti, grupi i treguesve të normalizuar, të cilët përdoren brenda një kategorie, janë shndërruar në një tregues të vetëm, të palidhur me anë të procedurës statistikore, përkatësisht sipas qasjes së Analizës së Komponentit Kryesor. Gjithashtu, ky tregues është normalizuar sërish përmes procedurës në ekuacionin 2. Më pas, treguesit e vlerësuar për secilën kategori janë shndërruar për të marrë vlerat [0, 1], duke përdorur metodën statistikore të shndërrimit eksponencial [1 / (1 + exp(-Z*)]. Në përfundim, matësi i stabilitetit bankar është ndërtuar si shuma e treguesve eksponencialë të vlerësuar për secilën kategori, si më poshtë:

$$CAELS_{t,w} = \omega_1 \sum_{i=1}^{n} Z^*_{t,C} + \omega_2 \sum_{i=1}^{n} Z^*_{t,A} + \omega_3 \sum_{i=1}^{n} Z^*_{t,E} + \omega_4 \sum_{i=1}^{n} Z^*_{t,L} + \omega_5 \sum_{i=1}^{n} Z^*_{t,S} \qquad (2)$$

$$\sum_{*=a,b,c,d,e} \omega^* = 1 \qquad (3)$$

Ku: n është numri i treguesve në secilën nënkategori; 'K' i referohet mjaftueshmërisë së kapitalit; 'A' përfaqëson një përafrues të cilësisë së aktiveve; 'E' përfaqëson një përafrues të fitimit; 'L' përfaqëson një përafrues të likuiditetit; dhe 'S' është një përafrues, i cili i referohet ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut. Të gjithë treguesit e përdorur brenda çdo kategorie janë raportuar në Tabelën 1 në Shtojcë. Z* është mesatarja e thjeshtë e transformuar në mënyrë eksponenciale e vlerave të normalizuara të çdo treguesi të përfshirë në secilin nënindeks, të cilët mblidhen së bashku sipas një peshe të njëjtë, për të formuar treguesin e stabilitetit bankar. Më pas, indeksi i llogaritur

[4] Kjo qasje është paraqitur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në Guidën e Përpilimit 2016 mbi treguesit e shëndetit financiar, por gjithashtu edhe nga autorë të tjerë, të tillë si Sere-Ejembi, et al., (2014).

[5] Normalizimi i vlerave shmang shtrembërimet që dalin nga diferencimi në mesataret e treguesve..

përdoret si matje relative, ku një rritje në vlerën e indeksit për çdo dimension të veçantë tregon një rrezik më të ulët në këtë dimension, për periudhën në fjalë, krahasuar me periudhat e tjera.

Përparësitë e kësaj qasjeje janë të trefishta. Së pari, siç paraqitet në Grafikun 2 në Shtojcë, CAELS përbën më tepër një mjet plotësues të dobishëm për ekzaminimin në vend, se sa një zëvendësues të instrumenteve që përdoren për këtë qëllim [Betz, et al., (2014)]. Në këtë mënyrë krijon një instrument gjithëpërfshirës të mbikëqyrjes së brendshme dhe një matës që mund të përdoret për të vlerësuar stabilitetin e bankave në kohë reale dhe në baza të njëtrajtshme, si dhe për të identifikuar ato institucione që kërkojnë mbikëqyrje dhe vëmendje të posaçme për shqetësimet, në lidhje me kushtet e sektorit bankar aktual dhe ato në të ardhmen. Së dyti, ajo bazohet në rekomandimin e Bankës Qendrore Evropiane, BQE (2007). Prandaj, ne besojmë se ky tregues pasqyron më mirë strukturën e sektorit financiar shqiptar, pasi i jep më tepër peshë sektorit bankar, ndërsa përfiton nga një gamë e gjerë e të dhënave në nivelin bankar. Së treti, për shkak të metodës së ndjekur, treguesi i stabilitetit në rastin tonë nuk paraqitet në formën e probabilitetit të ndodhisë sipas qasjes binare, e për pasojë të ofrojë edhe sinjale të rreme lidhur me episodet e brishtësisë bankare dhe/apo mjaftueshmërinë e të dhënave. Përkundrazi, llogaritja e tij bazohet në metodën statistikore sipas qasjes së PKK-së, e cila është mjaft e njohur për evidentimin e faktorit kryesor të lidhur me analizën tonë, pa humbur shumë informacione[6]. Për më tepër, metoda e ndjekur është një qasje më e thjeshtë dhe më e lehtë për t'u shpjeguar dhe zbatuar. Çka është më e rëndësishmja, lejon analizimin e gjendjes së bankës në kohë dhe është e zbatueshme për krahasimet midis bankave.

3.2. TREGUESI I PAVARUR

Literatura empirike pasqyron gjerësisht faktorët që përcaktojnë stabilitetin bankar, të cilët mund të karakterizohen në njërën anë me tregues makroekonomikë dhe në anën tjetër me tregues të tjerë

[6] Shih gjithashtu: Jolliffe (2002); Ringenér (2008); Abdi, et al., (2010) dhe James, et al., (2013).

që lidhen në mënyrë specifike me bankat dhe industrinë bankare. Prandaj, në modelin tonë ne kemi përzgjedhur një sërë treguesish të cilët përdoren gjerësisht në literaturën empirike dhe njëkohësisht plotësojnë kushtet e kampionit të përzgjedhur[7]. Prandaj, në modelin tonë, kemi përfshirë pesë tregues të pavarur. Së pari, në model u përfshinë dy tregues makroekonomikë, një tregues i lidhur me aktivitetin ekonomik dhe një tjetër i lidhur me rrezikun e sovranitetit primar, me qëllim shmangien e problemit të specifikimit të gabuar dhe kapjen e efekteve makroekonomike, të cilat mund të ndikojnë njëkohësisht në stabilitetin e bankës. Treguesi i parë, ai i lidhur me aktivitetin ekonomik, kap efektet që zhvillimi ekonomik ka mbi stabilitetin bankar. Pritet që një rritje më e lartë ekonomike dhe/ose një përmirësim i pritjeve mbi zhvillimet ekonomike, i cili rrit aftësinë e agjentëve ekonomikë për të përmbushur angazhimet e tyre, në të ardhmen, e bën brishtësinë bankare më pak të mundshme. Prandaj, pritet që treguesi i lidhur me aktivitetin ekonomik të ketë një shenjë pozitive. Nga ana tjetër, treguesi i lidhur me rrezikun sovran përfaqëson në mënyrë të përmbledhur koston (çmimin) e rreziqeve të mundshme makroekonomike (p.sh., rreziku politik, rreziku i kursit të këmbimit, risku makroekonomik, rreziku sovran dhe rreziku i transferimit) që lidhen me investimin në një vend të huaj. Ai mund të zvogëlojë marzhin e kthimit të pritur nga investimet e portofolit dhe duhet të merret parasysh kurdo, në rast se investoni jashtë vendit. Për shembull, ashtu si sugjeron Jutasompakorn, et al. (2014), një tregues i përshtatshëm për matjen e rrezikut primar sovran është diferenca midis normës së interesit të brendshme dhe asaj të një vendi (ekonomie) të supozuar pa rrezik për të investuar. Teorikisht, pritet që një rrezik më i lartë primar sovran të shkaktojë një rritje të normave të brendshme, e cila e ul aftësinë paguese dhe për pasojë, brishtësia bankare është më e mundshme, dhe anasjelltas [Domac dhe Martinez-Peria (2003)]. Me fjalë të tjera, ne presim që një rritje e spread-it midis normave vendase dhe atyre të huaja të ndikojë negativisht stabilitetin bankar.

Së dyti, në modelin e specifikuar u përfshi treguesi që lidhet me madhësinë e bankës, i cili gjithashtu supozohet se reflekton edhe aspekte të zhvillimeve të sektorit bankar. Ky tregues u përfshi

[7] Përfshirja e një numri të madh treguesish të pavarur do të bënte të pamundur analizën empirike, nisur edhe nga fakti se kampioni i përzgjedhur është relativisht i vogël.

nën argumentin se bankat analizojnë performancën e tyre duke e krahasuar me zhvillimet që pësojnë bankat e tjera homologe [Berger dhe Bouwman (2013)]. Pritet që ky tregues të ketë një koeficient pozitiv, duke supozuar se probabiliteti për të përballuar periudhat e brishtësisë rritet me madhësinë e bankës, në krahasim me bankat më të vogla. Pra, sa më e madhe të jetë banka, aq më e madhe është aftësia e saj për të përballuar periudhat e krizave. Megjithatë, mund të ndodhë që përtej një niveli të caktuar dhe/apo në kushte të caktuara, rritja e dominancës së një banke kundrejt bankave të tjera mund të jetë kundërproduktive. Nëse një përqindje më e lartë e tregut vjen përmes kapitalit më të lartë dhe/ose politikave më agresive, kjo mund të çojë në një atraktivitet më të lartë të produkteve të reja, por të rrezikshme, që sjell depozita më të larta dhe/ose një ndërmjetësim më të madh, dhe në këtë mënyrë, edhe një rritje të tërthortë të rrezikut bankar, si dhe probabilitet falimentimi [Besankoa dhe Kanatasb, (1996)].

Së fundmi, në modelin e specifikuar u përfshinë edhe dy tregues që lidhen në mënyrë specifike me treguesit bankarë. Në njërën anë, nisur nga sugjerimet e Hughes dhe Mester (2009), në model u përfshi një tregues mbi efikasitetin operacional të bankës, për të cilin Fiordelisi, et al. (2015) besojnë se është mjaft domethënës, nisur nga supozimi i tyre se autoritetet mbikëqyrëse mund të lejojnë bankat më të efektshme, p.sh. ato me menaxhim dhe cilësi relativisht më të mirë, fleksibilitet më të madh, krahasuar me gjendjen së tyre të përgjithshme të stabilitetit, ceteris paribus dhe anasjelltas. Për më tepër, Shawtari, et al., (2015) sugjeron se treguesi i efikasitetit operacional është një matës më i mirë i performancës së bankës, krahasuar me metodat mesatarizuese, të tilla si kthimi nga aktivet (RoA) dhe kthimi nga kapitali aksioner (RoE). Për këtë qëllim, çdo vendim në nivel bankar për ta bërë bankën më tërheqëse dhe/ose konkurruese dhe anasjelltas, do të pasqyrohet në treguesit e bilancit të bankës. Prandaj, pritet që një përmirësim i efikasitetit të bankës të shoqërohet me një rritje të shëndetit bankar dhe për pasojë, edhe të stabilitetit të saj. Në anën tjetër, analiza merr në konsideratë edhe një tregues që lidhet me shkallën e kapitalizimit të bankës. Për shembull, një sasi e mjaftueshme kapitali, e cila shërben si një amortizues dhe/ose element mirëqenieje të bankës nga pikëpamja e sigurisë, është gjithashtu i rëndësishëm për

veprimtarinë e përditshme operacionale të saj. Kjo për shkak se kapitali vepron si një tampon kundër humbjeve financiare, duke mbrojtur bankën nga rreziqet e paaftësisë paguese. Një nivel i mjaftueshëm kapital u mundëson bankave të përmbushin raportin minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit aksioner [Betz, et al. (2014)]. Prandaj, supozohet se çdo politikëbërje në nivel bankar pasqyrohet tek struktura dhe nevoja për mirëkapitalizimin e bankës dhe, në këtë mënyrë, stabiliteti supozohet se është kusht për levën financiare të saj. Prandaj, pritet që rreziku i aftësisë paguese të zvogëlohet me kapitalizimin e bankës, duke i lejuar asaj të absorbojë çdo goditje që mund të përjetojë. Prandaj, një raport i tillë pritet të jetë pozitivisht i lidhur me stabilitetin e bankës.

3.3 KAMPIONI I TË DHËNAVE

Kampioni i të dhënave përbëhet nga të dhëna me bazë tremujore për periudhën T3 2008 – T3 2015, e cila në total përfshin 448 observime për 28 periudha. Ato janë të grupuara sipas të dhënave të lidhura në mënyrë specifike me bankat individuale dhe atyre që lidhen me industrinë bankare, të cilat janë marrë nga bilanci kontabël i 16 bankave që operojnë në Shqipëri, si dhe grupi i të dhënave makroekonomike.

Treguesit e lidhur në mënyrë specifike me bankat dhe ata të lidhur me industrinë bankare, si dhe treguesi i stabilitetit bankar, janë llogaritur në mënyrë individuale për secilën bankë. CAELS-i mat stabilitetin bankar të llogaritur ashtu siç shpjegohet në Seksionin 3.1 (shih edhe Tabelën 2 në Shtojcë), i cili më pas është shndërruar një indeks, duke marrë si vit bazë mesataren e vitit 2010. EFIKASITETI shpreh raportin e shpenzimeve bruto ndaj të ardhurave bruto. LEVA përfaqëson raportin e kapitalit aksioner ndaj totalit të aktiveve të bankës. MADHËSIA lidhet me treguesit e lidhur në mënyrë specifike me sektorin bankar. Ai shprehet si raport i aktiveve të bankës ndaj totalit të aktiveve të sistemit bankar. Treguesit makroekonomikë janë tregues të agreguar, që përfaqësojnë gjendjen e ekonomisë. PBB-ja përfaqëson Prodhimin e Brendshëm Bruto. Ai është shndërruar në terma realë nëpërmjet deflatorit të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK). RSP-ja përfaqëson diferencën midis normës 12-mujore të

bonove të thesarit vendas dhe normës 12-mujore të bonove të thesarit gjerman. Ato janë shndërruar në terma realë, duke zbritur normën përkatëse të inflacionit vjetor të brendshëm dhe atij gjerman, të matur nga IÇK-ja shqiptare dhe ajo gjermane.

Të gjithë treguesit bazohen tek vlerat në fund të periudhës. Ata janë shndërruar në formë logaritmi, përveç RSP-së. Të dhënat për zhvillimin e këtij studimi bazohen në disa burime. Të dhënat mbi PBB-në dhe IÇK-në janë marrë nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Të dhënat mbi normën e bonove të thesarit vendas janë marrë nga Ministria e Financave. Të dhënat mbi bonot e thesarit dhe IÇK-në gjermane janë marrë nga Bloomberg-u. Pjesa tjetër e të dhënave është marrë nga Banka e Shqipërisë.

3.4. PËRQASJA EMPIRIKE

Analiza empirike lidhur me fokusin e këtij studimi u bazua në studimet e mëparshme që kanë të bëjnë me momentet e vështira të bankave, veçanërisht ato të realizuara nga Wheelock dhe Wilson (2000), Cole dhe White (2012), Betz, et al. (2014), Black, et al. (2016). Megjithatë, ndryshe prej tyre, ky studim fokusohet veçanërisht në analizimin e lidhjes midis rrezikut primar sovran dhe stabilitetit bankar. Prandaj, modeli është specifikuar si më poshtë:

$$CAELS_{i,t} = \alpha + \beta_i * X'_{i,t} + \varepsilon_{i,t} \qquad (4)$$

ku, CAELS shpreh stabilitetin bankar të bankës *i* në kohën *t*, ku *i* = 1, …, N dhe *t* = 1, …, T. $X'_{i,t}$ është një vektor i treguesve shpjegues të ndarë në tre kategori kryesore: $Banka'_{i,t}$ përfaqëson dy tregues shpjegues që lidhen në mënyrë specifike me veprimtarinë bankare, të tillë si efikasiteti operacional [EFIKASITETI] dhe leva financiare [LEVA] e bankave; $Tregu'_{i,t}$ përbëhet nga një tregues që paraqet pozicionin dominues dhe pjesën e tregut që bankat zotërojnë individualisht [MADHËSIA]; $Makroekonomia'_{i,t}$ përfaqëson dy tregues të agreguar që shpjegojnë rendimentin ekonomik [PBB] dhe efektet e përçimit të një rreziku sovran relativ më të lartë [RSP]. α është konstante. β_i është vektor i koeficientëve që dalin nga vlerësimi i modelit. $\varepsilon_{i,t}$ është norma e gabimit që supozohet të jetë

me shpërndarje të njëjtë (identike) dhe i pavarur, me mesatare 0 dhe variancë $\sigma_u^2 A = \pi r^2$.

Një problem potencial me Ekuacionin [4] lidhet më çështjen e endogjenitetit midis treguesve. Prandaj, vlerësuesit e mundësisë maksimale të ndodhisë[8] duhet të identifikojnë momentet, katrori i të cilëve minimizohen, në mënyrë që të kënaqin vetëm nëngrupin e kufizimeve korrekte. Për këtë arsye, analiza empirike bazohet në qasjen MPM, siç është propozuar nga Arellano dhe Bond (1991), si dhe Arellano dhe Bover (1995)[9]. Kjo qasje është gjithashtu e përshtatshme për të zgjidhur problemet e mundshme të endogjenitetit [Anderson dhe Hsiao (1981)]. Nga një këndvështrim praktik, treguesit e instrumentit bazohen në informacionin e mëparshëm të treguesve shpjegues të përdorur. Numri i tyre është kufizuar deri në 4 vonesa kohore, siç sugjerohet edhe nga Roodman (2006). Së pari, AR(1) dhe AR(2) janë testet e Arellano-Bond për autokorrelacionin e parë dhe të dytë të mbetjeve. Rezultatet e tyre duhet të jenë të tilla që të refuzojnë hipotezën zero që nuk ka korrelacion serial të rendit të parë dhe të mos hedhin poshtë hipotezën zero të korrelacionit serial të rendit të dytë të mbetjeve. Më pas, testi Sargan dhe Hensen përdoret për kufizime mbi identifikimin bazuar në analogjinë e kampionit të kushteve të momentit të përshtatura në procesin e vlerësimit, duke përcaktuar kështu vlefshmërinë e treguesve të instrumentit (d.m.th. testet e mungesës së korrelacionit serial dhe konsistencës së treguesve të instrumenteve). Pritet që metoda e diferencave të peshave të qasjes së MPM-së në hapin e parë (AB-1) të zgjidhë edhe paragjykimet e pavullnetshme [gabimet standarde (t-statistikat)]. Kjo për shkak të varësisë së saj nga vlerat e vlerësuara (duke përdorur mbetjet e vlerësuara nga një vlerësues me një hap), të cilat mund të çojnë në një përfundim statistikor asimptotik joreal[10]. Kjo vlen veçanërisht në rastin e një kampioni me të dhëna kohe relativisht të shkurtër [Arellano dhe Bond (1991)].

---

[8] Teknikisht njihet edhe si Maximum Likelihood estimators'.

[9] Han dhe Phillips (2010) sugjerojnë se qasja MPM është ndërtuar që të jetë në gjendje të arrijë identifikimin e pjesshëm të evolucionit stokastik dhe të jetë i fuqishëm ndaj komponentëve të mbetur jashtë modelit të specifikuar.

[10] Shih edhe Judson dhe Owen, (1999); Bond dhe Windmeijer (2002); Ansari dhe Goyal (2014).

4. REZULTATET EMPIRIKE

4.1. MODELI BAZË I VLERËSUAR

Ky seksion paraqet rezultatet e analizës empirike. Fillimisht, lidhur me procedurën e testimit të rrënjës njësi[11], rezultatet në Tabelën 3 në Shtojcë dëshmojnë se EFIKASITETI dhe LEVA janë të integruara të rendit zero I(0). Kjo do të thotë se ata janë stacionarë, prandaj hyjnë në model në nivel. Treguesit e tjerë, të tillë si: CAELS, BOONE, PBB dhe RSP; rezulton se bëhen stacionarë në rendin e parë, I(1). Kjo do të thotë se ata paraqesin karakteristika jostacionare. Prandaj, ata hyjnë në model si ndryshim i rendit të parë, pasi në këtë mënyrë shndërrohen në gjendje stacionare[12]. Në vijim, ky seksion pasqyron edhe gjetjet kryesore sipas modelit të specifikuar në ekuacionin [4], të cilat paraqiten në kolonën 1 në Tabelën 4 në Shtojcë. Rezultatet bazohen tek qasja MPM, ndërsa testet diagnostike dëshmojnë se analiza empirike është e qëndrueshme dhe në përputhje me kriteret e metodologjisë së zgjedhur[13]. Nga një vështrim mbi koeficientët e vlerësuar vihet re se ato kanë shenjat e pritura. Për shembull, RSP-ja ka efektin e pritur negativ ndaj stabilitetit bankar. Kjo nënkupton që amortizimi i këtij rreziku rrit stabilitetin e bankës dhe prandaj, rreziqet më të ulëta pritet të materializohen nëpërmjet përmirësimit të kushteve në të cilat bankat ndihen më komode dhe më të qëndrueshme. Ky rezultat plotëson gjetjet e Jutasompakorn, et al., (2014), por, nga ana tjetër, efekti margjinal i vlerësuar konsiderohet relativisht i vogël, edhe pse është statistikisht i rëndësishëm, në nivelin prej 10%. Kjo sugjeron që bankat i marrin në konsideratë goditjet negative që lidhen me këtë rrezik, por efekti i përçimit të tij në stabilitetin bankar ka qenë relativisht i vogël. Ky rezultat mund të shpjegohet nga disa faktorë. Së pari, huamarrja publike është orientuar drejt

[11] Qasja e testit të rrënjës së njësisë përfshin testet Dickey-Fuller i Zgjeruar (ADF) dhe Phillips-Perron (PP) Fisher Chi2, të cilat përdoren kryesisht për kampion me të dhëna në panel të pabalancuar, siç është shembulli ynë.

[12] Këto rezultate janë të qëndrueshme, gjithashtu ndaj testeve të tjera të rrënjës së njësisë, përfshirë testin e statistikës-W të Im, Pesaran dhe Shin dhe testin Fisher. Rezultatet mund të jepen sipas kërkesës.

[13] Vlerësimi empirik bazohet, gjithashtu, tek gabimet standarde dhe kovarianca (shkallët e lirisë të korrigjuara) sipas qasjes 'White Cross-Section'. Testet diagnostike bazohen tek rezultatet e testit Sargan dhe Hensen, dhe vlerave kritike të AR(1) dhe AR(2), të cilat raportohen në fund të Tabelës 4 në shtojcë.

huamarrjes më afatgjatë dhe veçanërisht drejt huamarrjes së huaj. Kjo ka ulur presionin mbi bankat dhe në të njëjtën kohë ka siguruar më shumë likuiditet për tregun. Së dyti, qeveria ka ndërmarrë disa reforma strukturore për të minimizuar rreziqet e mundshme fiskale, që përfshijnë reformën e sistemit të pensioneve, sektorin e energjisë etj. Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, bankat në Shqipëri kanë qenë të mirëkapitalizuara.

Nga ana tjetër, edhe koeficienti i PBB-së ka një shenjë pozitive, siç pritej. Kjo sugjeron, si në rastin e Demigruc-Kunt dhe Detragiache (2002), që rritja ekonomike ka një efekt pozitiv në stabilitetin e bankave. Efekti rezulton të jetë statistikisht i rëndësishëm në nivelin 1%. Prandaj, do të pritej që rritja më e lartë ekonomike të luante një rol relativisht vendimtar për kushtet e stabilitetit të bankës. Nga një këndvështrim tjetër, ky rezultat nënkupton që bankat gjithashtu kanë një rol relativisht të rëndësishëm për kushtet ekonomike në të cilat veprojnë, pasi një rritje në aktivitetin ekonomik do të përmirësonte situatën e sistemit bankar, nëpërmjet ndërmjetësimit financiar më të lartë ose rreziqeve më të ulëta që lidhen me rreziqet e sovranitetit të bankës.

Lidhur me treguesit e tjerë, rezultatet dëshmojnë se treguesi që lidhet me efektin e dominancës së bankës në treg, MADHËSIA, siç pritej, ka një efekt pozitiv ndaj stabilitetit. Koeficienti është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5%. Kjo nënkupton se ekonomia e shkallës ekziston në sektorin bankar shqiptar dhe efekti i saj ndaj stabilitetit është pozitiv. Pra, ashtu si në rastin e Berger dhe Bouwman (2013), vihet re se madhësia e bankës dhe vlera e aksioneve të tregut mund të jenë burim i fuqisë ekonomike për bankën dhe, ashtu si kapitali, ato mund t'i bëjnë bankat më tërheqëse dhe më të sigurta, si dhe u mundësojnë atyre të mbështesin nivele më të larta të kredisë me kosto më të ulët dhe të përballojnë më mirë momentet e krizave.

Në mënyrë të ngjashme, edhe treguesit e tjerë mikro janë gjetur gjithashtu të rëndësishëm për stabilitetin bankar. Ata kanë shenjën e pritur dhe janë statistikisht të rëndësishëm në nivel konvencional. Për shembull, EFIKASITETI ka një koeficient me shenjën e pritur negative, duke mbështetur ekzistencën e një lidhjeje të tërthortë midis tij dhe stabilitetit. Kjo nënkupton se stabiliteti bankar rritet proporcionalisht

me përmirësimin e efikasitetit operacional. Pra, një përmirësim i raportit të të ardhurave ndaj kostove pritet të përmirësojë kushtet në të cilat bankat operojnë. Kjo lidhje rezulton gjithashtu e rëndësishme nga pikëpamja statistikore në një nivel konvencional prej 10%, duke sugjeruar se çështjet operacionale janë themelore në aspektin e stabilitetit. Prandaj, bankat duhet të jenë të vetëdijshëm se çdo vendimmarrje e politikave, në një përpjekje për t'i bërë bankat më tërheqëse, e cila mund të ulë produktivitetin e saj, do të kishte kosto sa i përket stabilitetit të tyre. Arsyeja mund të jetë e dyfishtë. Së pari, në mënyrë që të jenë konkurruese, bankat mund ta kenë të vështirë të zhvendosin të gjithë koston ndaj huamarrësve. Së dyti, bankat e mëdha shpesh diktojnë normat e interesit në nivele të pamundura për bankat e tjera, duke i bërë ato jokonkurruese dhe për pasojë, aftësia e tyre për të mbuluar kostot fikse bie. Së fundmi, edhe treguesi i lidhur me efektin e kapitalit ndaj stabilitetit bankar shoqërohet nga një koeficient pozitiv i pritur. Pra, marrëdhënia midis LEVA-s dhe CAELS-it rezulton pozitive. Gjithashtu, marrëdhënia midis tyre rezulton të jetë statistikisht e rëndësishme në nivelin prej 1%. Kjo nënkupton se kapitalizimi i mirë i bankës është po ashtu një faktor mjaft thelbësor për stabilitetin. Vlen të përmendet se LEVA ka koeficientin më të lartë krahasuar me treguesit e tjerë. Kjo nuk është e habitshme, duke qenë se shumica e vendimmarrjes së politikës në nivel bankar bazohet në shkallën e kapitalizimit të bankës. Nga një pikëpamje politike, është mjaft e rëndësishme të kuptohet se rezultatet tregojnë se stabiliteti i bankave që veprojnë në Shqipëri është mjaft i ndjeshëm ndaj kapitalizimit të tyre. Prandaj, kjo sugjeron se bankat gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshme që politikat në lidhje me huadhënien apo stokun e depozitave, duhet të bazohen në shkallën e aftësisë së bankës për të përmbushur kërkesat e kapitalit minimal dhe të likuiditetit. Nga pikëpamja e politikave, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se treguesit mikro janë gjetur të kenë efektin më të lartë krahasuar me treguesit e tjerë makroekonomikë dhe me atë të lidhur me industrinë bankare. Pra, kjo nënkupton që stabiliteti i bankës është më i ndjeshëm ndaj zhvillimeve mikro se ndaj atyre makro.

4.2. KONTROLLI I FORTËSISË SË REZULTATEVE

4.2.1. MODELI BAZË I ZGJERUAR

Duke u bazuar tek studimi i Berger, et al. (2013), modeli i paraqitur në ekuacionin [4] u rishikua, duke përfshirë në të edhe një sërë treguesish të tjerë shpjegues, të jashtëm dhe të brendshëm, me qëllim për të shmangur problemin e specifikimit të gabuar. Në njërën anë qëndrojnë treguesit makroekonomikë që lidhen me efektet e politikës fiskale (BORXHI), stabilitetit financiar (ISF)[14]. Në anën tjetër, qëndrojnë treguesit e lidhur në mënyrë specifike me bilancin kontabël të bankave, domethënë: DK-ja për të kapur efektin e ndërmjetësimit financiar; DEPOZITA (KREDIA) për të llogaritur ndjeshmërinë e bankës ndaj nivelit të depozitave (kredive) në nivel individual; KAPITALI për të matur efektin që kapitali i tepërt ka në stabilitetin e bankës dhe; së fundi, KMP-ja, e cila pasqyron efektin e rrezikut të kredisë[15]. Ashtu si më parë, bazuar tek rezultatet e testeve të njësisë së rrënjës, modeli u vlerësua sipas qasjes MPM në nivel. Rezultatet e kësaj analize paraqiten në Tabelën [4], kolana (2) deri (9), në Shtojcë. Ato dëshmojnë se efekti i matur i treguesve kryesorë të analizuar në seksionin 4.1. mbetet i njëjtë, edhe pse në disa raste, niveli i tyre i rëndësisë ndryshon. Për shembull, RSP-ja shfaq përsëri të njëjtën marrëdhënie të tërthortë ndaj CAELS-it. Ky efekt vijon të mbetet përsëri më i ulëti krahasuar me treguesit e tjerë. Gjithashtu, vihet re se në disa modele efekti i tij është gjetur të jetë i parëndësishëm nga pikëpamja statistikore. Pra, këto rezultate dëshmojnë edhe një herë se përçimi i efekteve të rrezikut primar sovran ndaj stabilitetit bankar mbetet i ulët.

---

[14] BORXHI pasqyron raportin e borxhit publik ndaj PBB-së. ISF përfaqëson indeksin e stabilitetit financiar të llogaritur sipas Shijaku (2017). Ky tregues u shndërrua në një indeks, duke marrë si vit bazë mesataren e vitit 2010. Rritja e tij nënkupton përkeqësim të situatës, dhe anasjelltas. IÇB-ja shpreh indeksin e çmimit të banesave, të llogaritur si diferencë e parë e logaritmit të IÇB-së.

[15] DK-ja përfaqëson raportin e depozitave ndaj kredisë. DEPOZITA (KREDIA) paraqet stokun e depozitave (kredisë). KMP-ja shpreh raportin e kredive me probleme ndaj kredisë totale. KAPITALI është raporti i diferencës midis nivelit aktual të kapitalit aksioner dhe normës minimale të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas kriterit të Bazel II prej 12%. Të dhënat janë në nivel individual të bankave. Ato janë shndërruar në formë logaritmike, përveç KAPITALI-t. Treguesit janë gjetur se janë stacionarë I(0).

Nga ana tjetër, koeficienti i lidhur me PBB-në mbetet përsëri pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm, gjë që konfirmon se zhvillimet pozitive dhe pritjet makroekonomike janë thelbësisht të rëndësishme për nxitjen e stabilitetit bankar. Edhe treguesit e tjerë mbartin të njëjtin informacion. Kështu, këto rezultate tregojnë se MADHËSIA, ka ndikim pozitiv ndaj CAELS-it, edhe pse bëhet statistikisht e parëndësishmem. Nga ana tjetër, EFIKASITETI vazhdon të jetë negativisht i lidhur me CAELS-in. Në të njëjtën kohë, LEVA kontribuon pozitivisht ndaj CAELS-it. Të dy këta tregues vijojnë të jenë statistikisht të rëndësishëm në të gjitha modelet e vlerësuara.

Edhe analiza mbi treguesit e tjerë shpjegues dëshmon se gjetjet empirike janë relativisht të njëjta me pritjet teorike. Treguesit makroekonomikë të përfshirë në këtë analizë sugjerojnë se kushtet makroekonomike janë thelbësore për stabilitetin e bankave. Kështu, është gjetur se ISF-ja shoqërohet nga një koeficient me shenjën negative të pritur. Kjo tregon se goditjet pozitive në sektorin financiar priten të shoqërohen me një përmirësim të stabilitetit bankar. Kjo lidhje rezulton të jetë statistikisht e rëndësishme në nivelin prej 5%. Kjo nënkupton se zhvillimet në industrinë financiare janë mjaft thelbësore për sistemin bankar në tërësi, nisur nga ndërlidhja reciproke midis tyre. Prandaj, çdo zhvillim që lidhet me të pritet të pasqyrohet menjëherë në sektorin bankar. Në mënyrë të ngjashme, siç pritej, stabiliteti i bankave rezulton të ketë një marrëdhënie të tërthortë me dominancën fiskale. Ky rezultat është i ngjashëm edhe me gjetjet e Demirguc-Kunt dhe Detragiache (2005) për ekonomitë në zhvillim. Kjo tregon se orientimi i politikave drejt përmirësimit të pozicionit fiskal ndikon pozitivisht ndaj stabilitetit bankar. Njëkohësisht, lidhja midis tyre është gjetur të jetë statistikisht e rëndësishme, çka nënkupton se bankat në Shqipëri janë mjaft të ndjeshme ndaj pozicionit fiskal. Edhe zhvillimet që lidhen me sektorin e pasurive të patundshme rezulton të kenë një efekt negativ dhe statistikisht të rëndësishëm ndaj stabilitetit bankar, megjithëse, nisur nga vlera e koeficientit të gjetur, mund të thuhet se bankat janë relativisht pak të ndjeshme ndaj këtyre zhvillimeve. Këto rezultate dëshmojnë edhe njëherë se zhvillimet makroekonomike janë mjaft të rëndësishme për stabilitetin bankar.

Nga ana tjetër, edhe treguesit e tjerë të lidhur në mënyrë specifike me sjelljen e bankave në nivel individual rezulton se ka efektin e pritur, por, me përjashtim të KAPITALI-t, efekti i të cilit vlerësohet të jetë statistikisht i parëndësishëm dhe/ose relativisht i vogël. Për shembull, shenja pozitive e KD-së nënkupton se rritja e ndërmjetësimit financiar rrit stabilitetin bankar. Edhe DEPOZITA dhe KREDIA kanë gjithashtu[16] një koeficient pozitiv. Kjo tregon se rritja e stokut të depozitave dhe atij të kredisë, të cilat janë burimi kryesor i likuiditetit apo i investimeve të këtyre fondeve për bankat, rrit besimin në sektorin bankar. Pra, këto rezultate sugjerojnë se besimi i sektorit bankar rritet me rritjen e ndërmjetësimit financiar. Çuditërisht, efekti i tyre është gjetur të jetë statistikisht i parëndësishëm. Sa i përket treguesve të tjerë, shenja negative e koeficientit të lidhur, KMP, tregon se stabiliteti bankar është i lidhur në mënyrë të tërthortë me rrezikun e kredisë. Një marrëdhënie e tillë është në përputhje me pritjet a priori dhe në përputhje me gjetjet e mëparshme empirike të Cleary dhe Hebb (2016). Megjithatë, nga pikëpamja statistikore, ky efekt është gjetur të jetë i parëndësishëm. Së fundmi, vihet re se zhvillimet që lidhen me kapitalin rregullator të bankave rezultojnë të kenë një efekt mjaft të rëndësishëm për stabilitetin bankar, nisur edhe nga rëndësia statistikore e koeficientit të lidhur me KAPITALI-n. Shenja pozitive e tij sugjeron se rritja e stokut të kapitalit aksioner përtej nivelit minimal të lejuar, nxit më tej stabilitetin e bankave. Kjo nënkupton se kapitalizimi i mirë i bankave është thelbësor për stabilitetin e tyre, i cili konfirmon në një farë mënyre faktin se bankat që operojnë në Shqipëri arritën të përballonin me sukses efektet e krizës financiare falë kapitalizimit të mirë të tyre.

4.2.2. ANALIZIMI I EFEKTIT QË PËRFSHIRJA NË AKTIVITETET JASHTË BILANCIT KONTABËL KA NDAJ STABILITETIT BANKAR

Analizimi i mëtejshëm i fortësisë së rezultateve, ashtu si në rastin e Mirzaei, et al., (2013), përfshin në ekuacionin bazë edhe një tregues të lidhur me aktivitetet jashtë bilancit kontabël

[16] Rezultatet janë të njëjta edhe në rastin kur përdorim raportin e depozitave ndaj PBB-së dhe kredisë ndaj PBB-së.

(*OffBALANCE*)[17]. Kjo shërben për të matur masën me të cilën aktivitetet jotradicionale, në të cilat bankat janë të angazhuara, mund të ndikojnë në stabilitetin bankar. Përsëri, bazuar tek testet e njësisë së rrënjës, modeli u vlerësua sipas qasjes MPM në nivel. Ashtu si më parë, treguesit instrumentalë bazohen tek ata të përdorur në ekuacionin e parë, ndërsa numri i tyre përfshin 4 vonesa kohore për secilin instrument. Rezultatet e kësaj analize paraqiten në Tabelën (5), në Shtojcë. Së pari, rezultatet e lidhura me testet diagnostike mbështesin konsistencën e modelit dhe treguesit instrumentalë të përzgjedhur. Rezultatet e tjera konfirmojnë se analiza empirike nuk ndikohet nga përfshirja e treguesve të tjerë shpjegues. Nga ana tjetër, koeficientët e treguesve kryesorë janë relativisht dhe cilësisht të ngjashëm dhe konvergojnë në të njëjtat përfundime si më parë. Përveç kësaj, vihet re se OffBALANCE ka një koeficient me shenjë pozitive. Kjo tregon se kjo formë e bankingut, e cila kryesisht përfshin garanci për kreditë hipotekare, shoqërohet me një efekt pozitiv ndaj stabilitetit bankar. Pra, sa më i lartë është angazhimi i garancive që një bankë jep/merr, aq më i sigurt është pozicioni i saj gjatë momenteve të trazuara, si pasojë e këtyre garancive. Në fakt, ky mund të jetë edhe një nga faktorët që shpjegon lidhjen e parëndësishme midis stabilitetit bankar dhe zhvillimeve në sektorin e pasurive të paluajtshme. Megjithatë, nisur nga madhësia e efektit të matur dhe rëndësia statistikore, kjo marrëdhënie konsiderohet relativisht e vogël dhe e parëndësishme. Arsyeja është e dyfishtë. Së pari, ekspozimi i bankave në aktivitete të tilla është përqendruar kryesisht në angazhimet e bëra për mbulimin me kolateral të kredive hipotekare, të cilat kryesisht përbëjnë garanci nga të cilat bankat nuk gjenerojnë fitime. Së dyti, ekspozimi i bankave ndaj angazhimeve të bëra përbën vetëm një pjesë relativisht të vogël, shumica e të cilave lidhet me kompanitë e konsoliduara financiarisht dhe me kapitalizim të mirë.

[17] Zërat jashtë bilancit kontabël përfshijnë totalin e garancive të marra dhe të dhëna (të tilla si garanci bankare, kredi, letra me vlerë etj.) si raport ndaj totalit të aktiveve të bankës. Ky tregues është shprehur në formë logaritmike. Më pas, ai futet në model si diferencë e parë, sipas rezultateve të testit të rrënjës së njësisë.

5. KONKLUZIONE

Ky material diskutimi hulumton në mënyrë empirike lidhjen midis stabilitetit bankar dhe rrezikut primar sovran, në rastin e sistemit bankar shqiptar. Qëllimi i tij është të analizojë, nga pikëpamja empirike, nëse rreziku primar sovran ndikon në stabilitetin bankar, veçanërisht pas krizës financiare. Për këtë arsye, së pari, u llogarit një tregues i ri për stabilitetin bankar. Ai bazohet në të dhënat e bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare të bankave që raportohen në bazë të kriterit CAELS, të cilat u shndërruan në një matës të vetëm, nëpërmjet metodës së AKK-së. Më pas, informacioni i marrë u analizua nëpërmjet qasjes MPM, në të cilën u përfshinë tregues shpjegues të brendshëm dhe të jashtëm. Për më tepër, u shtri edhe në analizimin e shkallës ndaj të cilës rezultatet e marra janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve metodologjike të lidhura me përfshirjen e treguesve të tjerë shtesë, sipas qasjes së analizës së fortësisë së rezultateve.

Ky material plotëson literaturën ekzistuese lidhur me këtë çështje në tre aspekte kryesore. Së pari, në dijeninë tonë, ky është studimi i parë që adreson çështjet midis rrezikut primar sovran dhe stabilitetit, në rastin e një ekonomie në zhvillim, në veçanti në rastin e sistemit bankar shqiptar. Së dyti, treguesi i stabilitetit nuk bazohet tek treguesit e përdorur gjerësisht, të tillë si rezultati Z dhe/apo raporti i kredive me probleme (KMP), dhe/apo tregues të tjerë binarë. Në të kundërt, treguesi i përzgjedhur përfshin aspekte të ndryshme të rrezikut bankar. Prandaj, ne besojmë fuqimisht se ky tregues është cilësisht më i aftë për të identifikuar drejtpërdrejt faktorin kryesor që shpreh më mirë episodet e brishtësisë bankare në kohë, si dhe pa humbur shumë informacion. Edhe metoda e ndjekur për llogaritjen e tij ofron një instrument të thjeshtë për t'u kuptuar dhe që mund të përdoret për analiza periodike dhe sektoriale. Së fundmi, edhe baza e të dhënave përbën një burim më të saktë dhe më të besueshëm të të dhënave bankare, siç janë ato të marra nga Banka e Shqipërisë.

Në mënyrë të përmbledhur, ky studim konfirmon se shtrirja e efekteve të rrezikut primar sovran dhe ekspozimi i bankave ndaj këtij rreziku mbetet i ulët dhe statistikisht i parëndësishëm, ndonëse

zhvillimet që lidhen me situatën makroekonomike rezultojnë se kanë një efekt të rëndësishëm ndaj stabilitetit bankar. Ndër to vlen të përmendet se rreziku që lidhet me dominancën fiskale dhe brishtësia e sektorit financiar janë faktorët kryesorë që ndikojnë stabilitetin bankar. Nga ana tjetër edhe treguesit që lidhen me sektorin bankar rezultojnë se kanë një efekt të rëndësishëm ndaj stabilitetit bankar. Vlen të përmendet se dominanca e bankës në treg përbën një element tjetër të rëndësishëm për të përballuar situatat e goditjeve të pafavorshme. Gjithashtu, edhe treguesit që lidhen në mënyrë specifike me sjelljen bankare rezulton se e ndikojnë seriozisht stabilitetin. Vlen të theksohet se kapitali dhe efikasiteti operacional janë ndër faktorët thelbësorë për ecurinë e bankës në pikëpamje të rreziqeve të mundshme që lidhen me brishtësinë bankare. Ndërkohë, ndërmjetësimi financiar dhe rreziku i kredisë, ndonëse kanë një efekt sipas pritjes teorike, janë gjetur se janë relativisht të parëndësishëm. Kjo lidhje u gjet edhe në rastin kur kryem një analizë për të matur efektin e përfshirjes në aktivitetin jashtë bilancit kontabël. Një konkluzion i rëndësishëm lidhet me faktin se, pavarësisht qasjes metodologjike, rezultatet mbeten relativisht të njëjta dhe të pandryshuara.

Përtej fokusit të këtij studimi, puna kërkimore në të ardhmen duhet të përqendrohet në faktin se nevojiten hulumtime të mëtejshme, më të detajuara, për të kuptuar më mirë faktorët që ndikojnë stabilitetin bankar. Ndër to vlen të shikohet se si përqendrimi bankar dhe konkurrenca ndikojnë stabilitetin bankar. Gjithashtu, mjaft e rëndësishme është edhe analiza se si sjellja e kujdesshme e bankave nxit më tej stabilitetin. Një vëmendje e madhe duhet t'i kushtohet ndërtimit të treguesve kundraciklikë. Kuptueshëm edhe përmirësimi i mëtejshëm i treguesit të stabilitetit është thelbësor. Përfshirja e treguesve që lidhen me aspekte të menaxhimit bankar do të ofronin dëshmi mjaft të qenësishme në këtë aspekt.

LITERATURA

Abdi, Herve, Lynne Williams (2010). "Principal component analysis." Wiley Interdisciplinary Reviews: Computational Statistics. 2 (4): 433–459.

Anderson, Theodore, and Cheng Hsiao (1981). "Estimation of Dynamic Models with Error Components." Journal of American Statistical Association, 76(375), page: 598-606.

Ansari, Jugnu, and Ashima Goyal (2014). "Bank Competition, Managerial Efficiency and Interest Rate-Pass-through in India." Contemporary Issues in Bank Financial Management, in Simon Grima, Frank Bezzina (ed.), 97, Emerald Group Publishing Limited.

Antoniades, Adonis (2015). "Commercial bank failures during the Great Recession: the real (estate) story." European Central Bank, No 1779 / April 2015.

Arellano, Manuel, and Stephen Bond (1991). "Some Tests of Specification for Panel Data: Monte Carlo Evidence and an Apagelication to Employment Equations." The Review of Economic Studies, 58(2), page: 277-297.

Arellano, Manuel, and Oliver Bover (1995). "Another Look at the Instrumental Variables Estimation of Error Components Models." Journal of Econometrics 68(1), page: 29-51.

Aubuchon, Craig, David Wheelock (2010). "The geographic distribution and characteristics of U.S. bank failures, 2007-2010: do bank failures still reflect local economic conditions?" Federal Reserve Bank of St. Louis Review, 395–415.

Bank of Albania (2014). "Financial Stability Report - 2014 H2", Department of Financial Stability and Statistics, Bank of Albania.

Bank of Albania (2015). "Annual Report 2015", Bank of Albania.

Beltratti, Andrea, Ren Stulz (2012). "The credit crisis around the globe: Why did some banks perform better?" Journal of Financial Economics, 105(1): 1–17.

Berger, Allen, Leora Klapper, Rima Turk-Ariss (2009). "Bank Competition and Financial Stability." Journal of Financial Services Research, 35, page: 99-118.

Berger, Allen, and Christa Bouwman (2013). "How Does Capital Affect Bank Performance During Financial Crises?", Journal of Financial Economics, Vol. 19, (2013), 146-176.
Bernanke, Ben, Mark Gertler, and Simon Gilchrist (1992). "The Financial Accelerator and Flight to Quality."Review of Economics and Statistics, 78(1), page: 1-15.

Besankoa, David, and George Kanatasb (1996). "The Regulation of Bank Capital: Do Capital Standards Promote Bank Safety?." Journal of Financial Intermediation, 5(2), page: 160-183.

Betz, Frank, SilviuOprica, Tuomas Peltonen, and Peter Sarlin (2014). "Predicting Distress in European Banks." Journal of Banking and Finance, 45, page: 225-241.

Black, Lamont, Ricardo Correa, Xin Huang, and Hao Zhou (2016). "The Systemic Risk of European Banks during the Financial and Sovereign Debt Crises." Journal of Banking and Finance, 63, page: 107-125.

Bond, Stephen, and Frank Windmeijer (2002). "Finite Sample Interference for GMM Estimators in Linear Panel Data Models." Institute of Fiscal Studies, London, January (2002).

Boudebbous, Thouraya, and Jamel Chichti (2013). "Determinants of Systematic Banking Crises in the Countries of Central and Eastern Europe." Journal of Business Studies Quarterly, 5(1).

Campello, Murillo, Erasmo Giambona, John Graham, and Campbell Harvey (2011). "Liquidity Management and Corporate Investment during a Financial Crisis." Review of Financial Studies, 24(6): 1944–1979.

Caprio, Gerard, and Daniela Klingebiel (1997). "Bank Insolvency: Bad Luck, Bad Policy, or Bad Banking?." World Bank Economic Review, Annual World Bank Conference on Development Economics 1996, ©1997 The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.

Casu, Barbara, and Claudia Girardone (2005). "An Analysis of the Relevance of Off-balance Sheet Items in Explaining Productivity Change in European Banking." Applied Financial Economics, 15(15), page: 1053-1061.

Cevik, Emrah, SelDibooglu, and Ali Kutan (2013). "Measuring Financial Stress in Transition Economies." Journal of Financial Stability, 9, page: 597-611.

Cleary, Sean, and Greg Hebb (2016). "An Efficient and Functional Model for Predicting Bank Distress: In and out of Sample Evidence." Journal of Banking and Finance, 64, page: 101-111.

Cole, Rebel, Lawrence White (2012). "Déjà Vu All Over Again: The Causes of U.S. Commercial Bank Failures This Time Around." Journal of Financial Stability, 42(1): 5–29.

Dell'Ariccia, Giovanni, DenizIgan, and Luc Laeven (2008). "Credit Booms and Lending Standards: Evidence from the Subprime Mortgage Market."IMF Working Paper, WP/08/106 IMF, April (2008).

Demirgüç-Kunt, Asli, and Enrica Detragiache (2002). "Does Deposit Insurance Increase Banking System Stability? An Empirical Investigation", Journal of Monetary Economics, Vol. 49, 1373-1406.

Demirgüç-Kunt, Asli, and Enrica Detragiache (2005). "Cross-country Empirical Studies of Systemic Bank Distress: A Survey", National Institute Economic Review, National Institute of Economic and Social Research, Vol. 192 (1), 68-83.

Demirgüç-Kunt, Aslı, Enrica Detragiache, Thierry Tressel (2008). "Banking on the Principles: Compliance with Basel Core Principles and Bank Soundness." Journal of Financial Intermediation 17(4), page: 511-542.

Deutsche Bundesbank (2003). "Report on the Stability of the German Financial System", Monthly Report, December (2003).

DeYoung, Robert, and Gökhan Torna (2013). "Non-traditional Banking Activities and Bank Failures during the Financial Crisis." Journal of Financial Intermediation, 22(3), page: 397-421.

Diamond, Douglas, and Philip Dybving (1983). "Bank Runs, Deposit Insurance, and Liquidity." Journal of Political Economy, 90, page: 401-419.

Diamond, Douglas, and Raghuram Rajan (2005). "Liquidity Shortages and Banking Crises." Journal of Finance, 60(2), page: 615-647.

Domac, Ilker, and Maria Soledad Martinez-Peria (2003). "Banking Crises and Exchange Rate Regimes: Is There a Link?." Journal of International Economics, 61(1), page: 41-72.

Dushku, Elona (2016b). "Some Empirical Evidence of Loan Loss Provisions for Albanian Banks." Journal of Central Banking Theory and Practice, 2, page: 157-173.

Dwyer, Douglas, Jing Zhang, and Janet Yinqing Zhao (2011). "Usage and Exposures at Default of Corporate Credit Lines: An Empirical Study." Moody's Analytics.

Eichengreen, Barry, and Andrew Rose (1998), "Staying Afloat When the Wind Shifts: External Factors and Emerging-Market Banking Crises." NBER Working Paper No. 6370, January (1998).

European Central Bank (2007), "Progress Towards a Framework for Financial Stability Assessment", Speech by José Manuel González-Páramo, Member of the Executive Board of the ECB, OECD World Forum on "Statistics, Knowledge and Policy", Istanbul, June 2007.

Fahlenbrach, Rdiger, Robert Prilmeier, Ren Stulz (2012). "This Time Is the Same: Using Bank Performance in 1998 to Explain Bank Performance during the Recent Financial Crisis." Journal of Finance, 67(6): 2139–2185.

Fiordelisi, Franco, David Marques-Ibanez, and Phil Molyneux (2011). "Efficiency and Risk in European Banking." Journal of Banking & Finance, 35(5), page: 1315-1326.

Fiordelisi, Franco, Alessandro Carretta, VicenzoFarina, Stentella Lopes, and Paola Schwizer (2015). "Supervisory Styles and Financial Soundness toward the Banking Union." Journal of Banking and Finance, 52, page: 180-188.

Fu, Xiaoqing, Yongjia Lin, Philip Molyneux (2014). "Bank competition and financial stability in Asia Pacific." Journal of Banking & Finance, 38, page: 64–77.

Hagen, Jurgen Von, and Tai-kuang Ho (2007). "Money Market Pressure and the Determinants of Banking Crises." Journal of Money, Credit and Banking, 9(5), page: 1037-1066.

Hall, Alastair (2005). "Generalized Methods of Moments." Oxford University Press.

Han, Chirok, and Peter Phillips (2010). "GMM Estimation for Dynamic Panels with Fixed Effects and Strong Instruments at Unity." Econometric Theory, 26, page: 119-151.

Honohan, Patrick (2000). "Banking System Failures in Developing and Transition Countries: Diagnostics and Prediction." Economic Notes, Volume 29 (1), 83-109.

Hughes, Joseph, and Loretta Mester (2009). "Efficiency in Banking: Theory, Practice, and Evidence." Oxford Handbook of Banking, Oxford University Press.

Hutchison, Michael (2002). "European Banking Distress and EMU: Institutional and Macroeconomic Risks", The Scandinavian Journal of Economics, Vol. 104 (4), Macroeconomic Risk, Policies and Institutions, (Sep. 2002), 365-389.

Illing, Mark, Ying Liu (2006). "Measuring Financial Stress in a Developed Country: An application to Canada." Journal of Financial Stability, 2(3), page: 243-265.

IMF (2006), "Financial Soundness Indicators", Completion Guide, International Monetary Fund.

Ivashina, Victoria, David Scharfstein (2010). "Bank Lending During the Financial Crisis of 2008." Journal of Financial Economics, 97(3): 319–338.

Jahn, Nayan, and Thomas Kick (2012). "Determinants of Banking System Stability: A Macro-Prudential Analysis."Bank for International Settlements, April (2012).

James, Gareth, Daniela Witten, Trevor Hastie, and Robert Tibshirani (2013). "An Introduction to Statistical Learning with applications in R.", 6th Edition, Springer.

Jiménez, Gabriel, Jose Lopez, Jesús Saurina (2013). "How Does Competition Affect Bank Risk-taking?" Journal of Financial Stability, 9(2), page: 185-195.

Jolliffe, Ian (2002). "Principal Component Analysis." 2nd edition, Springer-Verlag.

Judson, Ruth, and Ann Owen (1999). "Estimating Dynamic Panel Data Models: A Guide for Macroeconomist." Economics Letters, 65, page: 9–15.

Jutasompakorn, Pearpilai, Robert Brookes, Christine Brown, and SirimonTreepongkaruna (2014). "Banking Crises: Identifying Dates and Determinants." Journal of International Financial Markets, Institutions and Money, 32, page: 150-166.

Kaminsky, G., Reinhart, C., (1998). "On crises, contagion and Confusion", Journal of International Economics, Vol. 51, 145-68.

Kasman, Saadet, Adnan Kasman (2015). "Bank Competition, Concentration and Financial Stability in the Turkish Banking Industry." Economic Systems, 39, page: 502-517.

Laeven, Luc, Ross Levine (2009). "Bank governance, regulation and risk taking." Journal of Financial Economics, 93(2): 259–275.

Mirzaei, Ali, Tomoe Moore, and Guy Liu (2013). "Does Market Structure Matter on Banks' Profitability and Stability? Emerging vs. Advanced Economies." Journal of Banking and Finance, 37(8), page: 2920-2937.

Noth, Felix, Lena Tonzer (2015). "Bank Risk Proxies and Crisis of 2007/09: A Comparison." Applied Economics Letter, 24: 498-501.

Ötker, Podpiera (2010). "The Fundamental Determinants of Credit Default Risk for European Large Complex Financial Institutions." IMF Working Paper WP10/153.

Pill, Huw, and Mahmood Pradhan (1997). "Financial Indicators and Financial Change: A Comparison of Africa and Asia." Savings and Development, 21(2), page: 123-150.

Ringenér, Markus (2008). "What is principal component analysis?." Nature Biotechnology, 26(3), Mach 2008.

Roodman, David (2009). "A Note on the Theme of Too Many Instruments." Oxford Bulletin of Economics and Statistics, 71(1), page: 135-158.

Sere-Ejembi, Angela, IniSalihu, Audu Salihu, Ngozi Atoi, and Baba Yaaba (2014). "Developing Banking System Stability Index for Nigeria."CBN Journal of Applied Statistics, 5(1).

Shatari, Fekri, Buerhan Saiti, Shaikh Hamzah Abdul Razak, Mohaned Ariff (2015). "The Impact of Efficiency on Discretionary Loans/Finance Loss Provision: A Comparative Study of Islamic and Conventional Banks." Borsa Istanbul Review 15(4): 272-282.

Shijaku, Gerti (2017a). "Fiscal Policy, output and financial stress in the case of Developing and Emerging European Economies: A Threshold VAR Approach.", Bank of Albania Working Paper 33 (72) 2017.

Shijaku, Gerti (2017b), "Probability of sudden sop of capital: the case of Albania." Bank of Albania, Working Paper 32 (71) 2017.

Uhde, André, Ulrich Heimeshoff (2009). "Consolidation in Banking and Financial Stability in Europe Further Evidence." Journal of Banking and Finance, 33, page: 1299-1311.

Wheelock, David, Paul, Wilson (2000). "Why Do Banks Disappear? The Determinants of U.S. Bank Failures and Acquisitions." The Review of the Economics and Statistics, 82(1), page: 127-138.

Grafik 1. Diferenca dhe stabiliteti i sistemit bankar



Burimi: Llogaritjet e autorit.

Tabela 1. Treguesit e përdorur për ndërtimin e indeksit të stabilitetit bankar

Kategoria	Treguesi	Simboli	Nënindeksi
Kapitali	Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit	C1	ZC
	Kapitali bazë/aktiveve totale	C2	
	Kapitali aksioner/aktiveve totale	C3	
	Norma e rritjes së aktiveve	C4	
	Norma e rritjes së kapitalit aksioner	C5	
	Aktive fikse/kapitali rregullator	C6	
	Kthimi nga kapitali aksioner	C7	
	Huatë me probleme (net)/kapitali rregullator	C*8	
Cilësia e aktiveve	Huatë me probleme (net)/ kredia totale (net)	A*1	ZA
	Kredia totale (net)/totali aktiveve	A2	
	Norma e rritjes së portofolit të kredisë	A3	
	Kredia e humbur (gross)/kredia totale (gross)	A*4	
	Rreziqet e mëdha (numri i përfituesve mbi normë)	A*5	
	Provigjionimi për mbulimin e kredisë së humbur/kredia me probleme (gross)	A*6	
Fitimi	Kthimi nga kapitali	E1	ZE
	Norma e rritjes së të ardhurave nga interesat	E2	
	Të ardhurat nga interesat/të ardhurat totale	E3	
	Marzhi neto nga interesat	E4	
	Norma e effikasitetit	E5	
	Të ardhurat nga interesat (net)/ të ardhurat operacionale (gross)	E6	
	Dividenti/të ardhura (net)	E7	
	Norma e rritjes së të ardhurave neto nga interesat	E8	
Likuiditeti	Kredia neto/Depozitat mesatare	L1	ZL
	Likuide aktive/aktive totale	L2	
	Aktive – pasive me maturitet deri në tre muaj/aktive totale që japin fitim	L3	
Ndjeshmëria ndaj rreziqeve të tregut	Aktive – pasive të ndjeshme nga norma e interesit me maturitet deri në 3 muaj/aktive totale që japin fitim	S*1	ZS
	Aktive – pasive të ndjeshme nga norma e interesit me maturitet deri në 12 muaj/aktive totale që japin fitim	S*2	
	Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj	S*3	

* e lidhur me rendin e kundërt të rrezikut.

Burimi: Llogaritje të autorit.

Grafiku 2. Treguesi i Stabilitetit Bankar Individual, me dhe pa AKK, norma e rritjes vjetore



Tabela 2. Karakteristikat e sektorit bankar, 2007 – 2016

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i bankave	16	16	16	16	16	16	16	16	16	16
Në pronësi shtetërore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Me kapital vendas	2	2	2	2	2	2	2	2	3	3
Me kapital të huaj	14	14	14	14	14	14	14	14	14	14
Ndërmjetësimi financiar	78.6	80.5	82.0	85.8	89.4	95.9	99.1	101.4	101.3	105.1
-aktive të bankave/ PBB	75.9	76.7	77.5	80.9	84.7	89.6	90.5	91.7	91.3	94.9
-aktive të tjera/ PBB	2.7	3.8	4.5	4.9	4.7	6.3	8.6	9.7	10	10.2
Kredia/ PBB					40.0	43.6	41.9	42.1	40.6	40.5
Depozitat/ GDP	63.6	58.4	58.6	64.0	68.3	71.0	72.4	73.0	72.9	74.2
IHH (në %)	16.5	15.1	14.3	14.2	14.3	14.5	13.8	14.1	14.9	15.3
RQ-4 (në %)	63.1	60.2	61.4	62.8	63.9	65.4	64.9	66.6	69.3	68.7

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti i Stabilitetit Financiar (2016).

Tabela 3. Testi i njësisë së rrënjës në panel.

Treguesi	ADF - Fisher Chi²			PP - Fisher Chi²		
	Konstante	Konstante dhe trend	Asgjë	Konstante	Konstante dhe trend	Asgjë
ΔCAELS	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0018]	[0.0000]	[0.0000]
ΔPBB	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[1.0000]	[0.0000]	[0.0000]
ΔRSP	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[1.0000]	[0.0000]
ISF	[0.0071]	[0.0000]	[0.0899]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0001]
ΔBORXHI	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]
IçB	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]
ΔMADHËSIA	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]
EFIKASITETI	[0.0000]	[0.0000]	[0.9649]	[0.0000]	[0.0000]	[0.8965]
LEVA	[0.0000[	[0.0007]	[0.0001]	[0.0000]	[0.0006]	[0.0010]
ΔDK	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]
ΔDEPOSITA	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]
ΔKREDIA	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]
ΔKMP	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]
KAPITALI	[0.0424]	[0.0537]	[0.3042]	[0.0000]	[0.0000]	[0.1607]
OffBALANCE	[0.0002]	[0.0149]	[0.9760]	[0.0000]	[0.0001]	[0.9669]
IKM	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]
REER	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]
PjBM0	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]	[0.0000]

Shënim: Δ është një tregues i diferencës së parë. Probabilitetet për testet Fisher janë përllogaritur duke përdorur një shpërndarje asimptonike Chi². Të gjitha testet e tjera supozojnë një asimptonike normale.

Burimi: Llogaritje të autorit.

Tabela 4. Rezultatet kryesore bazuar tek treguesit shpjegues makroekonomikë

Modeli i specifikuar	[1]	[2]	[3]	[4]	[5]	[6]	[7]	[8]	[9]
ΔPBB	1.0344***	1.3619***	1.2117***	1.0584**	0.9774*	0.9960**	0.9754**	1.1559**	1.1657**
ΔRSP	-0.0489*	-0.0225	-0.0287	-0.0610**	-0.0428	-0.0495*	-0.0436	-0.0402**	-0.0389
ΔISF		-0.2109**							
ΔBORXHI			-0.5560*						
ΔIçB				-0.0935***					
ΔMADHËSIA	0.1496**	0.1207	0.1431	0.1193	0.1137	0.1749	0.0813	0.0608	0.1423
EFIKASITETI	-0.4404*	-0.4528*	-0.5055**	-0.4622*	-0.4597**	-0.4283*	-0.4478*	-0.6496***	-0.4239*
LEVA	0.6121**	0.4141**	0.6533***	0.6217***	0.4820**	0.4281*	0.6509***	0.0839	0.6403*
ΔDK					0.0974				
ΔDEPOZITA						0.0684			
ΔKREDIA							-0.0986		
ΔKAPITALI								0.0215*	
ΔKMP									-0.0826*
Seksione të kryqëzuara	16	16	16	16	16	16	16	16	16
Rendi i instrumenteve	20	24	24	24	24	24	24	20	24
Numri i vrojtimeve	448	448	448	448	448	448	448	402	428
Statistika J	17.7	21.9	17.4	23.1	21.0	22.7	19.8	23.4	17.6
Probabiliteti [Statistika J]	0.28	0.23	0.50	0.19	0.28	0.20	0.34	0.17	0.48
AR(1) [vlera p]	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
AR(2) [vlera p]	0.2834	0.025	0.058	0.032	0.045	0.042	0.037	0.073	0.042
*Niveli konvencional i rëndësisë statistikore sipas ***1%, **5%, dhe *10%.*									

Burimi: Llogaritje të autorit.

Tabela 5. Rezultatet kryesore bazuar tek treguesit shpjegues makroekonomikë

Modeli i specifikuar	[1]	[2]	[3]	[4]	[5]	[6]	[7]	[8]	[9]
ΔPBB	1.037**	1.374***	1.191***	1.058***	0.984**	1.043***	1.032**	1.001**	1.168**
ΔRSP	-0.051*	-0.024	-0.033	-0.063***	-0.043	-0.049*	-0.041	-0.060**	-0.039
ΔISF		-0.233**							
ΔBORXHI			-0.487*						
ΔIçB				-0.096***					
ΔMADHËSIA	0.064	0.026	0.049	0.034	0.017	0.101	0.025	0.001	0.120
EFIKASITETI	-0.346*	-0.355*	-0.401*	-0.355	-0.368*	-0.349*	-0.359*	-0.436*	-0.281
LEVA	0.537***	0.352**	0.577***	0.596***	0.403**	0.345*	0.552**	0.011	0.527**
ΔDK					0.119				
ΔDEPOZITA						0.092			
ΔKREDIA							-0.070		
ΔKAPITALI								0.011*	
ΔKMP									-0.106*
ΔOFFBALANCE	0.012	0.014	0.012	0.015	0.013	0.012	0.009	0.011	0.034
Seksione të kryqëzuara	16	16	16	16	16	16	16	15	16
Rendi i instrumenteve	24	28	28	28	28	28	28	24	28
Numri i vrojtimeve	431	431	431	431	431	431	432	385	423
Statistika J	23.4	27.7	23.0	27.2	28.0	28.0	25.9	26.7	28.0
Probabiliteti [Statistika J]	0.18	0.15	0.34	0.17	0.14	0.14	0.21	0.08	0.14
AR(1) [vlera p]	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
AR(2) [vlera p]	0.031	0.071	0.041	0.022	0.037	0.035	0.029	0.072	0.031
*Niveli konvencional i rëndësisë statistikore sipas ***1%, **5%, dhe *10%.*									

Burimi: Llogaritje të autorit.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Shijaku, Gerti
A ndikon rreziku primar sovran mbi stabilitetin bankar? : evidenca nga sektori bankar shqiptar / Gerti Shijaku. – Tiranë : Banka e Shqipërisë, 2018
48 f. ; 15x21 cm. – (Material studimi)
Bibliogr.
ISBN 978-9928-262-08-0

1.Banka dhe veprimtaria bankare 2.Shqipëri

336.71(496.5)

ISBN 978-9928-262-08-0

www.bankofalbania.org

ISBN 978-9928-262-08-0